

PAKR.nr.616/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.H. nga Prishtina, për shkak të veprës penale blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, dhe D.K., gjithashtu nga Prishtina, për shkak të veprës penale blerja, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkritazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.H., av. A.H., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.176/2018 të datës 04.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 30.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.H., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.176/2018 të datës 04.12.2018, përkritazi me të akuzuarin A.H., vërtetohet.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.176/2018 të datës 04.12.2018, përkritazi me të akuzuarin D.K., mbetet i paprekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.176/2018 të datës 04.12.2018, të akuzuarit A.H. dhe D.K. janë shpallur fajtorë për veprat penale dhe atë; i akuzuari A.H., për vepër penale blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, ndërsa, i akuzuari D.K., për veprën penale blerja, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale janë gjykuar: i akuzuari A.H., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesë qind) €, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa, nëse i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë brenda afatit të paraparë ligjor, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.

05.02.2018 deri më datën 05.04.2018, ndërsa, i akuzuari D.K., është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katër qind) €, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa, nëse i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë brenda afatit të paraparë ligjor, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt. 05.02.2018 deri më datën 05.03.2018.

Të akuzuarit po ashtu, i ka obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç, shumën prej nga 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarve iu ka shqiptuar edhe dënimin plotësues dhe atë konfiskimin e substancës narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 26,9 gr, 14 qese të zbrazëta dhe shuma e parave në lartësi prej 50 €, të akuzuarit A.H., ndërsa, të akuzuarit D.K., konfiskimin e substancës narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 6,7 gram, si mjete me të cilat janë kryer veprat penale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av. A.H., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën i ka njoftuar Prokurorinë e Apelit, të akuzuarin A.H. dhe mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av. A.H.. Në seancën e kolegjit prezantuan mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av. A.H., ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantoi askush nga prokuroria e as i akuzuari A.H., prandaj, gjykata seancën e kolegjit e mbajti në mungesë të tyre konform dispozitave të nenit 390 par. 4 të KPK-së. Në seancën e kolegjit, mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av. A.H., pasi më parë elaboroi disa nga pretendimet ankimore në ankesë, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesë.

Prokuroria e Apelit, përmes parashtresës me shkrim PPA/l.nr.02/19, të datës 03.01.2019, i propozoi gjykatës që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesë aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase, as me ankesë nuk është kontestuar, pasi që edhe ashtu i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, që do të thotë se nuk ka të drejtë ankese në këtë drejtim, prandaj, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimor përkitazi me sanksionin penal-juridik.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit A.H., përkitazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë. Me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. A.H., potencohet se gjykata e shkallës së parë, i ka konstatuar shumicën e rrethanave lehtësuese, mirëpo të njëjtat nuk janë vlerësuar realisht e as në masë të duhur, sidomos kur merret parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë, pastaj, se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë dhe është penduar për një gjë të tillë, e sidomos duke marrë parasysh edhe praktikën e gjykatave, ku për rastet e ngjashme janë shqiptuar dënime më të buta e edhe dënime me kusht, i propozon gjykatës që ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim të kushtëzuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse ka vlerësuar të gjitha rrethanat ashtu sikur që parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPK-së, ku si rrethana lehtësuese të akuzuarit i ka marrë se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, ka pranuar fajësinë, moshën relativisht të re, prandaj, duke pasur parasysh edhe rrethanat që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes së veprës penale, ku të akuzuarit substanca narkotike në fjalë, përveç që i është gjetur të akuzuarit duke e shitur, një sasi tjetër e substancës narkotike i është gjetur edhe në shtëpi dhe atë e përgatitur po ashtu dhe e gatshme për shitje, pastaj, peshën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, gjë që mënyrën e vlerësimit të rrethanave nga gjykata e shkallës së parë, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë e sidomos kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjor. Prandaj, duke pasur parasysh të cekurat si më lartë, pretendimet e theksuara në ankesë nga mbrojtësit e të akuzuarit, nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin në zvogëlimin e mëtutjeshëm të dënimit, ngase, i njëjti vetëm i ka përsëritur rrethanat lehtësuese të konstatuara dhe vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, për çka konsiderojmë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, dhe atë nën minimumin ligjor, është i drejtë dhe i ligjshëm nga se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikshmërisë së veprës penale, e po ashtu është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, rrethanat e rastit konkret, rrethanat në të cilat është zhvilluar ngjarja kritike, rezulton se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.616/2018, më dt. 30.01.2019

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
1. _____
Xhevdet Abazi
2. _____
Tonka Berishaj

Kryetar i kolegjit,
Fillim Skoro

